



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 9219 Prot
Shkodër, më 01.07.2020



Nr. _____ Prot
Shkodër, më 01.07.2020

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot me datë ___/___/2020 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi mes palëve:

BASHKISË SHKODËR me adresë Rr. "13 Dhjetori", Nr 1, Shkodër, përfaqësuar nga Znj. Voltana ADEMI, në cilësinë e titullarit të Institucionit, në vijim referuar edhe si "**Bashkia**";

dhe

SHOQATA GREEN CENTRE ALBANIA (GCA), me selinë rrugën "Rr: Hasan Riza Pasha, Ndërtesa e Dhomës së Tregtisë, Kati III, Shkodër, përfaqësuar nga zj. Anila Neziri me nr. NIPT-i K67303001Q, në cilësinë e kryetarit të shoqatës, në vijim referuar dhe si "**Shoqata**".


Duke qënë se Palët:

Vlerësojnë rëndësinë e zhvillimit të qendrueshëm ekonomik të Bashkisë Shkodër.

Marrin në konsideratë politikat zhvillimore të Bashkisë Shkodër në drejtim të organizimit të aktiviteteve që synojnë promovimin e vlerave natyrore, kulturore dhe produkteve të territorit të Bashkisë Shkodër.

Synojnë realizimin objektivave zhvillimore të Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.

Njohin eksperiencën e Shoqatës Green Centre Albania, e cila e përbërë nga profesionistë të fushës angazhohen në mbrojtjen dhe ruajtjen e burimeve natyrore, ndërmarrjen e veprimeve konkrete në mjedis për përmirësimin e balancave ekologjike si dhe mbështetjen e mjedisit të kërkimit shkencor.



Konfirmojnë angazhimin institucional për të bashkëpunuar në vijim të projektit 'Turizëm i qëndrueshëm dhe promovim i produkteve agroushqimore në zonën e Anës së Malit, financuar nga IUCN dhe PAP/RAC.

Palët së bashku bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (këtu e më poshtë referuar si "**Marrëveshja**"), si më poshtë vijon:

Neni 1 **Baza ligjore**

- 1.1 Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
- 1.2 Kodi Civil ligji nr.7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar;
- 1.3 Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar;
- 1.4 Ligji nr.93/2015, "Për Turizmin" i ndryshuar;
- 1.5 Strategjia territoriale e Bashkisë Shkodër 2015 – 2030.

Neni 2 **Qellimi**

Kjo kontratë ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Bashkisë Shkodër dhe Shoqatës Green Centre Albania në kuadër të projektit "**Turizëm i qëndrueshëm dhe promovim i produkteve agroushqimore në zonën e Anës së Malit**, me qëllim ruajtjen dhe promovimin e vlerave ekologjike, kulturore dhe produkteve vendase të njësive administrative të Bashkisë Shkodër.


Neni 3 **Objekti i marrëveshjes**

Bashkëpunim në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, nëpërmjet organizimit të panairëve për promovimin e vlerave dhe produkteve të territorit të Bashkisë Shkodër sipas planit të aktiviteteve të Shoqatës Green Centre Albania, bashkëlidhur kësaj marrëveshje.

Neni 4 **Afati i marrëveshjes**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet nga palët me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, me afat nga momenti i nënshkrimit të saj deri me datë 12.07.2020.

Neni 5 **Angazhimi i palëve**



Bashkia Shkodër merr përsipër:

- a) Të vendos në dispozicion të Shoqatës Green Centre Albania (GCA) sheshin për zhvillimin e aktivitetit, sipas planit të aktiviteteve bashkëlidhur kësaj marrëveshje.
- b) Të sigurojë dhe vendos në dispozicion të Shoqatës Green Centre Albania (GCA) informacionin e nevojshëm për mbarëvajtjen e aktiviteteve;
- c) Të koordinojë dhe monitorojë organizmin e aktiviteteve për zhvillimin e panairit për promovimin e vlerave dhe produkteve të territorit për Nj.A Ana e Malit si dhe panairin e produkteve agropërpunuese në Shkodër;
- d) Të njoftojë Green Centre Albania (GCA) për çdo vështirësi të identifikuar që ka lidhje me aktivitetin e saj.
- e) Të vlerësojë efektshmërinë e panireve të organizuara.

Shoqata Green Centre Albania (GCA) merr përsipër:

- a) Të organizojë panairin në respektim planit të aktiviteteve të paraqitur në kërkesën e saj me datë 30.06.2020
- b) Të respektojë planin e aktiviteteve të panireve, miratuar nga Bashkinë Shkodër.
- c) Të mirëmbajë sheshin e rregullt dhe në fund të dorëzojë sheshin në të njëjtën gjendje që është marrë në dorëzim, në të kundërt do të penalizohet sipas dispozitave ligjore.
- d) Për panairin e organizuar nga shoqata në kuadër të kësaj marrëveshje, pjesmarrja e fermerëve në këto panire duhet të jetë pa pagesë ndaj çdo pale të tretë.
- e) Të njoftojë Bashkinë Shkodër në rast zhvillimi të aktiviteteve promovionale si dhe për çdo aktivitetet shtesë.
- f) Të njoftojë Bashkinë Shkodër për çdo vështirësi të identifikuar gjatë zbatimit të marrëveshjes.


**Neni 6
Komunikimi**

Çdo komunikim midis palëve do të bëhet me shkrim.

**Neni 7
Njoftimet**

- 7.1 Çdo njoftim, kërkesë apo çdo lloj komunikimi mes palëve do të bëhet sipas mënyrës së parashikuar në këtë marrëveshje bashkëpunimi.
- 7.2 Njoftimi i palëve do të bëhet me shkrim brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e faktit dhe problemeve që mund të lindin gjatë ekzekutimit të marrëveshjes.

**Neni 8
Zgjidhja e marrëveshjes**



- 8.1 Asnjëra nga palët nuk ka të drejtë të zgjidhë këtë marrëveshje në mënyrë të njëanshme pa shkaqe të arsyeshme dhe para se të kenë njoftuar me shkrim njëra-tjetrën të paktën 5 ditë përpara.
- 8.2 Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje apo kontradite do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim.
- 8.3 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshje ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrëveshjes dhe procedurave juridike në fuqi, sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 9


Dispozitat e fundit

- 9.1 Pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj marrëveshje është kalendari vjetor i panairëve bashkëlidhur kësaj marrëveshje.
- 9.2 Kjo marrëveshje bashkëpunimi do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.
- 9.3 Kjo marrëveshje u hartuar në tre kopje, nga të cilat njërën e merr shoqata ndërsa dy Bashkia Shkodër.

**PËR
BASHKINË SHKODËR**

KRYETAR

Voltana Ademi



**PËR
SHOQATËN**

KRYETAR

Anila Neziri



ANEKSI I

PLANI I AKTIVITETEVE

Nr.	Datat	Evenimentet	Vendi
1	10/07/2020	Panair agroushqimor në fshatin Oblike, Nj.A Ana e Malit	Nj.A Ana e Malit
2	12/07/2020	Panair agroushqimor në pedonalen e qytetit të Shkodrës	Pedonale "Kolë Idromeno" Shkodër

